



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
SEKTORI I PROKURIMEVE**

Nr. _____ prot.

Durrës, më _____.____.2024

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

Drejtuar: ASI-2A CO Shpk me NIPT K53002402C, me adresë: Fier, Rruga Skenderbeu, Lagjia Bishanake, pallati nr 18, hyrja nr. 6.

Procedura e prokurimit/lotit: “Procedurë e Hapur, Punë”

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-91817-12-21-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Rikonstrukcion shkolla 9 vjeçare "Demokracia",

Fondi limit: 47.500.000 (dyzet e shtatë milion e pesëqind mijë) lekë, pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës 105 (ditë).

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini datë 26 Dhjetor 2023, Nr. 103.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. KOMBEAS Shpk

NIPT K88103301J

Vlera 31'938'683 (tridhjetë e një milion e nëntëqind e tridhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre) lekë.

2. C O L O M B O Shpk

NIPT J82916489E

Vlera 34'284'415 (tridhjetë e katër milion e dyqind e tetëdhjetë e katër mijë e katërqind e pesëmbëdhjetë) lekë.

3. BOE NIKA Shpk NIPT J76705047U + NDERTUESI 2014 Shpk NIPT L46827004L
Vlera 34'327'640 (tridhjetë e katër milion e treqind e njëzet e shtatë mijë e gjashtëqind e dyzet) lekë.

4. ASI-2A CO Shpk NIPT K53002402C
Vlera 34'954'350 (tridhjetë e katër milion e nëntëqind e pesëdhjetë e katër mijë e treqind e pesëdhjetë) lekë.

5. NDERTIMI Shpk NIPT K11325002C
Vlera 36'443'433 (tridhjetë e gjashtë milion e katërqind e dyzet e tre mijë e katërqind e tridhjetë e tre) lekë.

6. BOE MF INVEST GROUP Shpk NIPT L71830010R + MANE/S Shpk NIPT J64103865K
Vlera 36'535'525 (tridhjetë e gjashtë milion e pesëqind e tridhjetë e pesë mijë e pesëqind e njëzet e pesë) lekë.

7. BOE NGRACAN 1934 Shpk NIPT J87602809S + 2Z KONSTRUKSION Shpk NIPT J63229466K
Vlera 37'083'315 (tridhjetë e shtatë milion e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e pesëmbëdhjetë) lekë.

8. ERGI Shpk NIPT K02727229P
Vlera 37'235'268 (tridhjetë e shtatë milion e dyqind e tridhjetë e pesë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë.

9. INA Shpk NIPT J61814009W
Vlera 37'488'230 (tridhjetë e shtatë milion e katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë e dyqind e tridhjetë) lekë.

10. BOE ERIL B&B Shpk NIPT L81426509M + RRUGE SINJALISTIKE MIREMBAJTJE & HIDRO COMPANY NIPT L04803001U + DESARET COMPANY Shpk NIPT K01816001J
Vlera 37'857'530 (tridhjetë e shtatë milion e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e tridhjetë) lekë

11. BOE LIS KONSTRUKSION Shpk NIPT K66613407H + VIANTE KONSTRUKSION Shpk NIPT K47103804L
Vlera 38'186'224.76 (tridhjetë e tetë milion e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e njëzet e katër presje shtatëdhjetë e gjashtë) lekë.

12. KEVIN CONSTRUCTION Shpk NIPT K71401004W
Vlera 38'314'940.10 (tridhjetë e tetë milion e treqind e katërmëdhjetë mijë e nëntëqind e dyzet presje dhjetë) lekë.

13. L.T.E CONSTRUCTION Shpk NIPT L78006801F
Vlera 39'006'861.40 (tridhjetë e nëntë milion e gjashtë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e një presje dyzet) lekë.

14. SENKA Shpk NIPT J94808405Q
Vlera 39'424'485 (tridhjetë e nëntë milion e katërqind e njëzet e katër mijë e katërqind e tetëdhjetë e pesë) lekë.
15. PEPA GROUP Shpk NIPT L42215009L
Vlera 39'659'263.30 (tridhjetë e nëntë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tre presje tridhjetë) lekë.
16. MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE Shpk NIPT K81314023A
Vlera 39'809'810 (tridhjetë e nëntë milion e tetëqind e nëntë mijë e tetëqind e dhjetë) lekë
17. LIQENI VII Shpk NIPT K01730502W
Vlera 39'819'283 (tridhjetë e nëntë milion e tetëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e tre) lekë
18. T&XH Shpk NIPT L72121504I
Vlera 39'898'761 (tridhjetë e nëntë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një) lekë
19. STERKAJ Shpk NIPT J68310708M
Vlera 43'001'625 (dyzet e tre milion e një mijë e gjashtëqind e njëzet e pesë) lekë
20. AGB3 Shpk NIPT L22321003R
Vlera 43'360'440 (dyzet e tre milion e treqind e gjashtëdhjetë mijë e katërqind e dyzet) lekë
21. LEON KONSTRUKSION Shpk NIPT K71820009I
Vlera 45'598'443 (dyzet e pesë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e katërqind e dyzet e tre) lekë

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. NIKA Shpk NIPT J76705047U, për arsyet e mëposhtme:

- Për ofertuesin NIKA me NIPT J76705047U (31,64%) + NDERTUESI 2014 me NIPT L46827004L (68,36%), me vlerë të ofertës 34'327'640 lekë, Komisioni i Vleresimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vleresimit të dokumentacionit për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik NIKA + NDERTUESI 2014:

1. Nuk përmbush piken 2.3.a të Kapacitetit Teknik ku citohet “*Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 23'000'000 Lekë, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 92'000'000 lekë...*”, pasi referuar dokumentacionit të paraqitur, subjekti NDERTUESI 2014 pjesë e BOE, ka paraqitur punën e ngjashme me objekt “Rikonstruksion i bllokut të sallave

operatore në shërbimin e urgjencës”, me autoritet kontraktor Spitali Rajonal Shkodër, në të cilën, NDERTUESI 2014 ka 30,84% të punimeve, vlerë e pamjaftueshme për përmbushjen e kriterit.

Referuar VKM nr. 285, date 19.05.2021, e ndryshuar, perkatesisht neni 88, pika 3, paragrafi 2, duke qene anëtar i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim, vleren monetare te percaktuar ne piken 2.3.a.a) te Kapacitetit Teknik duhet ta permbush te plote, dhe jo sipas përqindjes se pjesëmarrjes ne bashkim.

2. Nuk përmbush piken 2.3.m te Kapacitetit Teknik ku citohet “*Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë: Teknik ndertimi 1 punonjës; Murator 2 punonjës; Bojaxhi 4 punonjës; Elektracist 2 punonjës; Hidroizolues 1 punonjës; Hidraulik 2 punonjës; Pllakashtrues 4 punonjës; Drejtues mjete 2 punonjës; Saldator 1 punonjës; Punonjes karpentier 1 punonjës; Punonjes hekurkthyes 1 punonjës; Punonjes per punime gipsi 2 punonjës; Punonjes suvaxhi 4 punonjës; Punëtore ndertimi te thjeshte 21 punonjës*”, pasi subjekti NIKA pjese e BOE, referuar ndarjes se punimeve, ka marre persiper punime hidroizolimi, dhe nuk ka vetedeklaruar punonjes hidroizolues per realizimin e ketyre punimeve.

Ky arsyetim bazohet edhe ne vendimin e KPP Nr. 1129/2022, me nr. 2345/4 prot., date 22.11.2022.

2. C O L O M B O Shpk NIPT J82916489E, për arsyet e mëposhtme:

- Për ofertuesin C O L O M B O me NIPT J82916489E, me vlerë të ofertës 34’284’415 lekë, me ofertë ekonomike të korigjuar në vlerën 35’209’965 lekë, Komisioni i Vleresimit te Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit te dokumentacionit per permbushjen e kriterave per kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik C O L O M B O:

1. Në formularin e ofertes ekonomike sipas Shtojces 1 eshte deklaruar vlera 34’284’415 lekë, ndersa referuar preventivit te korigjuar vlera e përllogaritur është 35’209’965 lekë, me një diferencë prej 925’550 lekë. Bazuar në nenin 82, të VKM nr. 285, date 19.02.2021, Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave pika c) ofertat me gabime refuzohen kur: - Shuma absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertes ekonomike të ofruar. Për sa më sipër KVO konstaton se ofertuesi ka dorëzuar ofertë ekonomike ku vlera absolute e të gjitha korigjimeve është më shumë se 2% e vlerës së ofertës.

3. BOE MF INVEST GROUP Shpk NIPT L71830010R + MANE/S Shpk NIPT J64103865K, për arsyet e mëposhtme:

Për ofertuesin MF INVEST GROUP me NIPT L71830010R (80%) + MANE/S me NIPT J64103865K (20%), me vlerë të ofertës 36’535’525 lekë, Komisioni i Vleresimit te Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit te dokumentacionit per permbushjen e kriterave per kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik MF INVEST GROUP + MANE/S:

1. Nuk përmbush piken 2.2.b te Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar ku citohet “*Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021, 2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ne perputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 Per auditimin ligjor,*

organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar, i ndryshuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, pasi subjekti MF INVEST GROUP, pjesë e BOE, nuk ka paraqitur asnjë nga bilancet vjetore të kërkuara.

2. Nuk përmbush piken 2.3.m te Kapacitetit Teknik ku citohet “Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë: Teknik ndertimi 1 punonjës; Murator 2 punonjës; Bojaxhi 4 punonjës; Elektracist 2 punonjës; Hidroizolues 1 punonjës; Hidraulik 2 punonjës; Pllakashtrues 4 punonjës; Drejtues mjete 2 punonjës; Saldator 1 punonjës; Punonjes karpentier 1 punonjës; Punonjes hekurkthyes 1 punonjës; Punonjes per punime gipsi 2 punonjës; Punonjes suvaxhi 4 punonjës; Punëtore ndertimi te thjeshte 21 punonjës”, pasi subjekti MANE/S pjesë e BOE, referuar ndarjes se punimeve, ka marre persiper 20% të totalit të preventivit, dhe nuk ka vetedeklaruar asnjë punonjës të specializuar/të kualifikuar per realizimin e ketyre punimeve.

3. Nuk përmbush piken 2.3.n te Kapacitetit Teknik ku citohet “Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme: Kamiona vetshkarkues kapaciteti mbajtes minimalisht deri ne 10 ton - 1 copë; Kamioncin me kapacitet mbajtes 3.5-5 Ton – 1 copë; Kamioncine me kapacitet mbajtes jo me shume se 1 ton – 1 copë; Skela – 1000 m2; Nivelues per shtresa betoni – 1 copë; Matrapik per prishje e ndertimeve – 2 copë; Fadrome – 1 copë; Autovinc – 1 copë; Minieskavator – 1 copë; Betoniere / vellimi 1 m3 – 2 copë; Autobetoniere – 2 copë; Autobot Uji – 1 copë”, pasi referuar vetedeklarimeve të BOE, nuk disponohet Nivelues per shtresa betoni dhe Matrapiku per prishje e ndertimeve (vetedeklaruar 1 nga 2 te kerkuar).

4. BOE NGRACAN 1934 Shpk NIPT J87602809S + 2Z KONSTRUKSION Shpk NIPT J63229466K, për arsyet e mëposhtme:

- Për ofertuesin NGRACAN 1934 me NIPT J87602809S (35%) + 2Z KONSTRUKSION me NIPT J63229466K (65%), me vlerë të ofertës 37'083'315 lekë, Komisioni i Vleresimit te Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit te dokumentacionit per permbushjen e kriterave per kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik NGRACAN 1934 + 2Z KONSTRUKSION:

1. Nuk përmbush piken 2.3.m te Kapacitetit Teknik ku citohet “Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë: Teknik ndertimi 1 punonjës; Murator 2 punonjës; Bojaxhi 4 punonjës; Elektracist 2 punonjës; Hidroizolues 1 punonjës; Hidraulik 2 punonjës; Pllakashtrues 4 punonjës; Drejtues mjete 2 punonjës; Saldator 1 punonjës; Punonjes karpentier 1 punonjës; Punonjes hekurkthyes 1 punonjës; Punonjes per punime gipsi 2 punonjës; Punonjes suvaxhi 4 punonjës; Punëtore ndertimi te thjeshte 21 punonjës”, pasi mungon 1 punonjes per punime gipsi, pasi nga BOE eshte vetedeklaruar 1 punonjës për punime gipsi nga 2 te kerkuar;

2. Nuk përmbush piken 2.3.o te Kapacitetit Teknik ku citohet “Certifikate ISO 9001 - Sistemi i Menaxhimit të cilësisë, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo certifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi”, pasi certifikata ISO 9001:2015 e paraqitur nga subjekti NGRACAN 1934, pas verifikimit te saj, rezulton te jete me status “pezulluar”.

3. Nuk permbush piken 2.3.p te Kapacitetit Teknik ku citohet “*Certifikate ISO 18001/45001 - Sistemi i manaxhimit te sigurise dhe shendetit ne vendet e punes, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë*”, pasi certifikata ISO 45001:2018 e paraqitur nga subjekti NGRACAN 1934, pas verifikimit te saj, rezulton te jete me status “pezulluar”.

5. BEO ERIL B&B Shpk NIPT L81426509M + RRUGE SINJALISTIKE MIREMBAJTJE & HIDRO COMPANY Shpk NIPT L04803001U + DESARET COMPANY Shpk NIPT K01816001J, për arsyet e mëposhtme:

- Për ofertuesin ERIL B&B me NIPT L81426509M (5%) + RRUGE SINJALISTIKE MIREMBAJTJE & HIDRO COMPANY me NIPT L04803001U (55%) + DESARET COMPANY me NIPT K01816001J (40%), me vlerë të ofertës 37’857’530 lekë, Komisioni i Vleresimit te Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit te dokumentacionit per permbushjen e kriterëve per kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik ERIL B&B + RRUGE SINJALISTIKE MIREMBAJTJE & HIDRO COMPANY + DESARET COMPANY:

1. Nuk permbush piken 2.3.m te Kapacitetit Teknik ku citohet “*Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë: Teknik ndertimi 1 punonjës; Murator 2 punonjës; Bojaxhi 4 punonjës; Elektracist 2 punonjës; Hidroizolues 1 punonjës; Hidraulik 2 punonjës; Pllakashtrues 4 punonjës; Drejtues mjete 2 punonjës; Saldator 1 punonjës; Punonjes karpentier 1 punonjës; Punonjes hekurkthyes 1 punonjës; Punonjes per punime gipsi 2 punonjës; Punonjes suvaxhi 4 punonjës; Punëtore ndertimi te thjeshte 21 punonjës*”, pasi:

- subjekti ERIL B&B pjese e BOE, referuar ndarjes se punimeve, ka marre persiper punime hidroizolimi, dhe nuk ka vetedeklaruar punonjes hidroizolues per realizimin e ketyre punimeve;

- subjekti ERIL B&B pjese e BOE, referuar ndarjes se punimeve, ka marre persiper punime hidraulike, dhe nuk ka vetedeklaruar punonjes hidraulik per realizimin e ketyre punimeve.

Ky arsyetim bazohet edhe ne vendimin e KPP Nr. 1129/2022, me nr. 2345/4 prot., date 22.11.2022.

6. BOE LIS KONSTRUKSION Shpk NIPT K66613407H + VIANTE KONSTRUKSION Shpk NIPT K47103804L, për arsyet e mëposhtme:

- Për ofertuesin LIS KONSTRUKSION me NIPT K66613407H (70,30%) + VIANTE KONSTRUKSION me NIPT K47103804L (29.70%), me vlerë të ofertës 38’186’224.76 lekë, Komisioni i Vleresimit te Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit te dokumentacionit per permbushjen e kriterëve per kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik LIS KONSTRUKSION + VIANTE KONSTRUKSION:

1. Nuk permbush piken 2.3.b te Kapacitetit Teknik ku citohet “*Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme: NP–1A Punime gjermimi në tokë; NS–1A Punime për prishjen e ndërtimeve; NP–2A Ndertime Civile dhe industrial; NS–4B Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to,*

rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese; NS-2A Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre; NS-12A Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit; NS-14A Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV; NS-18A Punime topogjeodezike”, pasi subjekti VIANTE KONSTRUKSION pjese e BOE, nuk ka paraqitur licencen profesionale ne permbushje te ketij kriteri.

7. ERGI Shpk NIPT K02727229P, për arsyet e mëposhtme:

- Për ofertuesin ERGI me NIPT K02727229P, me vlerë të ofertës 37'235'268 lekë, dhe ofertë ekonomike të korigjuar në vlerën 38'607'268 lekë, Komisioni i Vleresimit te Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit te dokumentacionit per permbushjen e kriterave per kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik ERGI:

1. Në formularin e ofertes ekonomike sipas Shtojces 1 eshte deklaruar vlera 37'235'268 lekë, ndersa referuar preventivit vlera e përlllogaritur është 38'607'268 lekë, me një diferencë prej 1'372'000 lekë. Bazuar në nenin 82, të VKM nr. 285, date 19.02.2021, Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave pika c) ofertat me gabime refuzohen kur: - Shuma absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertes ekonomike të ofruar. Për sa më sipër KVO konstaton se ofertuesi ka dorëzuar ofertë ekonomike ku vlera absolute e të gjitha korigjimeve është më shumë se 2% e vlerës së ofertës.

8. AGB3 Shpk NIPT L22321003R, për arsyet e mëposhtme:

- Për ofertuesin AGB3 me NIPT L22321003R, me vlerë të ofertës 43'360'440 lekë, me ofertë ekonomike të korigjuar në vlerën 47'182'100 lekë, me subjekt mbeshtetes ANTE-GROUP me NIPT J62904100D, Komisioni i Vleresimit te Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit te dokumentacionit per permbushjen e kriterave per kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik AGB3:

1. Në formularin e ofertes ekonomike sipas Shtojces 1 eshte deklaruar vlera 43'360'440 lekë, ndersa referuar preventivit te korigjuar vlera e përlllogaritur është 47'182'100 lekë, me një diferencë prej 3'821'660 lekë. Bazuar në nenin 82, të VKM nr. 285, date 19.02.2021, Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave pika c) ofertat me gabime refuzohen kur: - Shuma absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertes ekonomike të ofruar. Për sa më sipër KVO konstaton se ofertuesi ka dorëzuar ofertë ekonomike ku vlera absolute e të gjitha korigjimeve është më shumë se 2% e vlerës së ofertës.

9. KOMBEAS Shpk NIPT K88103301J, për arsyet e mëposhtme:

- Në pergjigje te ofertës anomalisht te ulët, ofertuesi KOMBEAS me NIPT K88103301J, me vlerë të ofertës 31'938'683 lekë, ka kthyer pergjigje në sistemin elektronik të prokurimeve dhe shkresërisht për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëpërmjet shkresës nr. 14 prot., datë 16.01.2024, me nr. regjistri 513, datë 18.01.2024.

Për sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se shpjegimet e operatorëve ekonomikë për ofertën anomalisht të ulët, duhet të lidhen me kushtet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nga ku katër kushtet e para janë të

natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë vështrim. Mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore, çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të lex specialis. Në interpretim literal të nenit 93, pika 1, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si anomalisht e ulët. Gjithashtu, argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative, për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik do të përmbushë me sukses kontratën. Së pari, operatori ekonomik ankimes duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit – analizën teknike për zërat e preventivit, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punës. Gjithashtu, në përgjigje të kërkesës për argumentim oferte anomalisht të ulët, janë cituar edhe disa kontrata afatgjatë furnizimesh me operatorë të ndryshëm, por pa i dokumentuar këto kontrata. Është detyrë e operatorëve ekonomikë, oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët, të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punës dhe furnizimeve të propozuara nga ofertuesi. Ata gjithashtu duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, në vendin ku do të kryhet puna, si edhe së fundmi të argumentojnë apo provojnë mundësinë e tyre për të përfituar ndihmë shtetërore. Referuar nenit 93 pika 3 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

Nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofertë, e cila rezulton anomalisht e ulët. Risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime, ndër të tjera si: rreziku për moskryerjen e punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kostot që i lindin autoritetit nga moskryerja e punës brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e punës gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët.

Gjithashtu, referuar nenit 2 gërma “b” “Qëllimi” i ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se; “Qëllimi i këtij ligji është: b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale”. Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës, që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përllogaritjes të parashikuar në ligj.

Sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon vetëm mbi dokumentet e dorëzuara pranë autoritetit kontraktor.

Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik KOMBEAS, në mbështetje të ofertës anomalisht të ulët të paraqitur, rezulton se ky i fundit nuk është konform kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Konkretisht, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se operatori ekonomik KOMBEAS, nuk ka paraqitur dokumentacion mbështetës ose provues të sqarimeve të dhëna të ofertës në mënyrë narrative, ku ka shpjeguar arsyet e ofertimit të vlerës së ulët të ofertës së paraqitur prej tij, por duke mos justifikuar çmimin e ofertuar. Përveç kësaj, nuk ka paraqitur as analizë teknike për zërat e preventivit objekt-prokurimi, në përmbushje të gërmës a) të nenit 93 të LPP ku flitet për anën ekonomike të metodës së ndërtimit. Gjithashtu, nga ana e operatorit ekonomik KOMBEAS nuk është dorëzuar asnjë dokument provues si mbi metodën e ndërtimit të ofertës ekonomike, mbi të cilën edhe operatori ekonomik ka ofertuar, zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe ose ndonjë kusht favorizues, origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi; pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, duke mos argumentuar se pse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet dhe se nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës. Argumentimi i dhënë nga ofertuesi, në rastin konkret nuk krijon bindjen, se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

Në përfundim të arsytimit, në mënyrë të përmbledhur, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave arrin në konkluzionin se oferta e paraqitur nga KOMBEAS, duke qenë në kushtet e ofertës anomalisht të ulët nuk është bërë sipas kërkesave të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 93, Oferta anomalisht e ulët, duke mos dhënë shpjegime për anën ekonomike sipas kriterëve: a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit; b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës; c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi; ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës; d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

Operatori ekonomik KOMBEAS nuk ka asnjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm i cili do të përlligjte këtë ofertë, si dhe nuk provon përpara autoritetit kontraktor asnjë zgjidhje teknike e cila mund ta favorizojë për realizimin e kontratës. Gjithashtu, në përgjigje të kërkesës për argumentim oferte anomalisht të ulët, janë cituar edhe disa kontrata afatgjatë furnizimesh me operatorë të ndryshëm, por pa i dokumentuar këto kontrata. Përveç kësaj, nuk ka paraqitur as analizë teknike për zërat e preventivit objekt-prokurimi, në përmbushje të gërmës a) të nenit 93 të LPP ku flitet për anën ekonomike të metodës së ndërtimit. Oferta anomalisht e ulët e paraqitur nga operatori ekonomik KOMBEAS jo vetëm nuk justifikohet sipas kërkesave të nenit 93 të LPP-së por rrezikon seriozisht që të mos realizojë me sukses objektin e kontratës.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë ASI-2A CO Shpk me NIPT K53002402C, me adresë: Fier, Rruga Skenderbeu, Lagjia Bishanake, pallati nr 18, hyrja nr. 6., se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 34'954'350 (tridhjetë e katër milion e nëntëqind e

pesëdhjetë e katër mijë e treqind e pesëdhjetë) lekë pa Tvsh / totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Bashkia Durrës, Njësia e Prokurimit, *njesia.prokurimeve@durres.gov.al*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 36'443'433 (tridhjetë e gjashtë milion e katërqind e dyzet e tre mijë e katërqind e tridhjetë e tre), siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)

Vendimi i Komisioni i Prokurimit Publik **Nr. 189/2024, me nr. 239/8 prot., datë 16.02.2024.**

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Emiriana Sako